



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPKI
Nr. i fsh. Braj stranimë Nr. pagesë	02
Nr. Prot. Bj. Prot. Prot. No.	06-02/3101/22
Data Datum	28-07-2022
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1, nenit 5 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.07.2022, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-2596/22, për zyrtarin e lartë publik z. Ferat Shala, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të mundshëm interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Ferat Shala, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare e ka hapur rastin për situatë të mundshme të konfliktit të interesit ndaj z. Shala, pasi që i njëjti duke qenë zyrtar i lartë publik, njëkohësisht mbante edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar/anëtarit të bordit në biznesin privat, situatë kjo e cila bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Për t'i vërtetuar pretendimet, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar informata dhe dokumentacion nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Nga informatat e pranuar përmes shkresës zyrtare, është konstatuar se z. Shala e mbante funksionin e përfaqësuesit të autorizuar/anëtarit të bordit në biznesin privat, "SBA" L.L.C.

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit përmes shkresës (AKK-DPKI-06-02/2552/22) e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit.



Pas dërgimit të kësaj shkrese, Agjencia kundër Korrupsionit ka kontaktuar me z. Shala dhe e ka njoftuar atë se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar/anëtarit të bordit në biznes privat, pasi që një gjë e tillë bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”,

Zyrtari i lartë, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.


Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-02/2552-1/22) me dokumentet përcjellëse, në bazë të së cilave dëshmohet se zyrtari i lartë, ka ndërmarr veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke u dorëhequr nga funksioni i përfaqësuesit të autorizuar/anëtarit të bordit në biznesin privat.

Me veprimet e ndërmarra nga z. Shala, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


YLLI BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

